



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 10-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 19. 07. 2018, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Naim Stullca, anëtar
3. Mehmetali Krasniqi, anëtar
4. Nehat Tërpeza, anëtar
5. Fadil Sopa, anëtar
6. Hyra Bytyçi, anëtare
7. Linda Shahini, anëtare
8. Anila Reçica, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Naim Jahiri, anëtar
11. Majlinda Sylejmani, anëtare
12. Lulzim Rrustemi, anëtar
13. Ramiz Qeriqi, anëtar
14. Argjent Tasholli, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Selatin Retkoceri, anëtar
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Arben Salihu, anëtar
30. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunes për komunitete

4. Rasim Hasani, drejtor i DA
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP,
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH
10. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
11. Emina Rexhiqi, drejtoreshë e DPU-së
12. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
13. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
14. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
15. Islam Kaleshi, zyra ligjore
16. Përfaqësues të OSBE-së
17. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
18. Ylber Reçica, OJQ "POLIS"
19. Përfaqësues të mediave dhe
20. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarët nga gjithsejt 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 9-të e Kuvendit
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2018
3. Propozim vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e tregut të kafshëve dhe vendosjen e tregut për produktet ushqimore për kafshë, lëndë djegëse në ZK. Grackë e Vjetër.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, kompanisë regjionale Pastrimi-Prishtinë, njësia operative në Lipjan.
5. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit "Sami Kelmendi" në Lipjan.
6. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.
7. Informatë rreth testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës-afati Qershorit 2018
8. Prezentimi i Raportit të Auditorit të Pavarur të Kosovës për pasqyrat financiare për vitin 2017 të Komunës së Lipjanit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës. Shkelzen Bislimi, kisha kërku që pika e 8-të raporti të kaloj si pike e 2-të e rendit të ditës. Daut Azemi, tha se raporti dhe informata nuk votohen dhe për këtë arsyeje i kemi radhit të fundit pastaj e hodhi në votim dhe me 16 vota për 13 kundër dhe 1 apstenim kalon.

Pastaj Kryesuesi tha kalojmë në pyetjet parlamentare?

Lulzim Rrustemi, kam për t'i ngritur dy qështje e kemi një aset për pronat te QMI-ja të cilat janë në shfrytëzim e cilat jo. Çështja tjetër tregu i kafëshve çka është bërë me atë pjesë pasi që

ju keni thenë që I kemi afër procedurat. Sheshi “Adem Jashari” çdo ditë po uzurpohet, është mire të ketë konkurrencë të barabart për të gjithë.

Shkelzen Bislimi, kërkoj të vendosen pengesa para çdo objekti shkollor. Te rrethrotullimi te ETC-ja të vendost një trotuar pasi qytetarët nuk po munden të kalojnë, shtyllat në rrugën 4 korsi kanë filluar të dëmtohen kërkoj të intervenohet. Po ashtu të punohet funksionalizohet parku i ish të rënëve të fashizmit te shtëpia e kulturës.

Argjent Tasholli, tha se a kini menduar ndonjë herë të bëni spërkatjet e mushkonjave në qytetin e Lipjanit dhe fshatrat e Lipjanit. Pse mungojnë billbordet mire se vini diasporë. Në Gadime a kini dale t'i shihni dëmet që janë bërë gjatë vërshimeve.

Arben Salihu, lokalet që janë dhënë për parti politike a do të ketë në të ardhmen lokale të tilla edhe për partitë tjera apo jo.

Nazmi Krasniqi, shqetësim kam për rrugën kahë kisha nuk funksionon ndriqimi publik. Sa i përket vërshimeve a ka ndonjë raport për dëmet që janë shkaktuar gjatë vërshimeve.

Ramiz Qeriqi, në fshatin Sllovi rruga Agron Gashi gypat e ujit nuk janë vendosur kërkoj të intervenohet. Prapa ABE-es ka qenë një asfaltt është hiq është qit një asfaltt tjetër ndërsa pjesa ku banoj unë ka mbetur pa asfaltt vetëm në zallë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, pyeti se komuna a ka dal me bërë ndonjë analizë të ujit sidomos nëpër fshatra të cilat nuk janë të lidhura me ujësjellës.

Albulena Kelmendi, tha se lokalet te sheshi dhe zhurma e madhe e muzikës pas ores 12 të natës nuk po respektohen kisha kërku nga inspektorati por edhe nga ju Kryetar të bëni presion më të madh ne polici për këtë qeshtje. Rruga te kuzhina Ari po ndërtohet diçka dhe trotuari te ajo rrugë është uzurpuar nga punë kryersi pyes se a jini ne dijeni për këtë qeshtje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se pronat te QMI-ja i kemi pruar raportet te ju dhe do t'i bijmë përsëri por i keni edhe në web faqen e komunës. Pronat te Sitnica për kategorit e dalura nga lufta lënda ka shkuar në komision ndërministror dhe ata po merren me këtë qeshtje. Sa i përket uzurpimit të sheshit shumica e tyre kanë leje dhe janë duke bërë pagesë. Analizat e ujit kemi pasur dhe nga kompania ujësjellësi uji është ndërprerë për disa ditë. Sa i përket parkut na e kemi fituar një donacion nga MAPL-ja dhe do të ndërtohet. Sa i përket mërgatës me 2 gusht do të jetë dita e mërgatës ku do të ketë edhe aktivitete të shumta. Sa i përket ndriqimit ka kisha do të shohim dhe do të bëjmë një zgjidhje. Sa i përket vërshimeve ne nuk kemi fond por kemi bërë Kerkesën ministri po presim qka do të bëjnë por nëse ata nuk bëjnë asgjë ne me ridestinim do të shohim një zgjidhje. Sa i përket zyreve të partive dy parti kanë marrë zyret por ne do të kemi prap edhe për parti tjera.

Illir Tasholli, ne kemi dalë kur kanë filluar punimet në rrugën prapa ABE-se dhe menagjeri është ai i cili e ka mbikqyrë punën por nëse menagjeri ka bërë ndonjë lëshim ne do ta thrasim në përgjegjësi. Sa i përket ndriqimit publik sa herë po kemi njoftime nga tereni ne po mundohemi ta rregullojmë.

Nazmi Krasniqi, tha se në mandatin e kaluar kam kërkuar një raport të dihet saktë se sa përsone janë punësu, çka është investu.

Ramiz Qeriqi, unë kisha kërkuar që në të ardhmen me na i sjell projektin për me pa saktë po ashtu kisha dashtë me dalë së bashku në teren. Po ashtu kam një pyetje te tokat te QMI-ja që janë marrur nga Bena-fi kam dëgjuar se na ka paditur në gjygj si është puna.

Lumturije-Bytyqi-Hasani, nuk është mirë me folë në bazën e thash e thënave por në bazën e argumenteve.

Argjent Tasholli, nuk është qëllimi i jonë me i ndërpre lokalet në shesh por me i ndalu disa dukuri negative që e dëmtojnë sheshin.

Lulzim Rrustemi, ne si opozitë kemi propozimet, idetë, konceptet tjera për dallim prej juve. Sa i përket operatovëve që veprojnë në sheshë do të ishte mirë të ketë një kënd të veçant në shesh dhe të ketë konkurrencë të lirë. Ndërsa për tokat te QMI-ja në të cilat nuk kanë punuar asgjë të mirret dhe t'i ipen dikujt tjetër. E për parkun unë këtë e kam propozuar në Komitetin për urbanizëm. Ndërsa sa i përket sheshit ne ende konsiderojmë se sheshi është jashtë ligjshëm.

Albulena Kelmendi, edhe ne opozita dallojmë në mes veti, mendoj që duhet të kemi një qasje më të mirë. Është e mirë që Kryetari po merr pjesë në seancat e Kuvendit dhe po raporton. Sa i përket sheshit shihet se ka fituar një gjallëri dhe mua më pëlqen, por nuk më pëlqen zhurma që po bëhet.

Imri Ahmeti, sa i përket pronave të QMI-ja aty po thuaj se pak prej tyre kanë punuar sot diqka por në seancat e ardhshme do të keni një raport. Ndërsa për zhurmën në qytet ka të drejtë Albulena ne do të ndërmarrim masa për ndalimin e muzikës pas orarit të paraparë.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalu në pikën e parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 9-te e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Selatin Retkoceri, tha se kamë vërejtje në faqen 3 se gjatë diskutimit tim në disa raste nuk më është shkruar ashtu siqë kam thënë.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 9-te dhe pas votimit konstatoi se me vërejtjen e Selatin Retkocerit, Kuvendi me të gjitha votat për

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 9-te e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2018

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2018

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, te grantet qeveritare janë shpenzuar vetëm 72% të mjeteve. Te mallrat dhe shërbimet janë shpenzuar vetëm 240 mijë euro, ndërsa te arsimi dhe shëndetësia po teprojnë mjetet kur dihet që këto kanë më së shumti nevojë. Te investimet kapitale është për keqëardhje. Te pagesat te thesari, i kujt është faji për këto pagesa. Te planifikimi dhe të hyrat vetanake është kopi past si në vitet e kaluara. Po ashtu raporti ka shumë gabime gjuhësore dhe është mirë që t'i përmirësoni para se t'i qitni në web faqen e komunës.

Nazmi Krasniqi, gjatë një takimi me organizatën Polis, shihet se në shkollën "Zenel Hajdini" është i regjistruar një automjet në emër të kësaj shkolle, e pyes drejtorin lidhur me këtë qështje.

Hyra Bytyqi, ne si grup parlamentar i LDK-se, e kemi vlerësuar dhe sipas fondeve burimore është një buxhet real.

Selatin Retkoceri, të hyrat vetanake janë shpenzuar mirë. Të hyrat e bartura nuk janë mirë, po ashtu mallra dhe shërbime përqindja e pa kënaqëshme, shpenzimet komunale janë mirë. Subvencione dhe transfere shifër jo e mirë, investimet kapitale janë për t'u shqetësuar. Shërbimet Publike nevojat janë shumë më të mëdha, bujqësia, zhvillimi ekonomik në përgjithësi jo mirë. Është mirë të ceket se cilat rrugë nëpër fshatra do të asfaltohen jo të shkruhet vetëm emri i fshatit po ashtu në vitin 2018 kemi 30 projekte që përsëriten nga vitet e kaluara. Udhëtimet jashtë vendit janë pak dhe duhet ket sa ma shumë udhetime të kërkohen sa më shumë investime. Sa i përket karburanteve gjendja mendoj që është shqetësuese ku në këtë vit kemi rritje 11 mijë euro. Te Dreka vrehet se kemi ramje. Shqetësuese është edhe

posta dhe komunikimi ku në krahasim me vitin e kaluar kemi 1`2 mijë ero më shumë, Servisimi i veturave ka pasur rritje. Te shërbimet kontraktuese duhet të jemi më të kujdesshëm. Shërbime këshillimore ka pak, te informimi publik kemi shifer të rritur, furnizimi në zyre normal ndërsa në shëndetësi shqetësues. Gjykata dhe thesari, ka operatorët që kërkojnë kompensim nga komuna ku kjo po i merr buxhet komunës në shumën 600 mijë euro. Te mirëmbajtja investive ka ramje. Shkolla si p.sh: “Hasan Zuko Kamberi” ka bërë rexhistrimin e një veture, a kanë shkollat vetura. Edhe për këtë një sqarim.

Afrim Miftari, dilemat që i kemi pasur te ky raport na i sqaroj në KPF Visari por e kemi vetëm një kërkesë që në të ardhmen të shihen krahasimet me komuna tjera.

Lulzim Rrustemi, te grantet qeveritare te hyrat ,dhe të hyrat vetanake të bartura shpenzimi është i vogël. Te pagat dhe medijtjet shpenzimi është i mirë. Te subvencionet dhe transferet si dhe te investimet kapitale shpenzimi mjaft i vogël. Të hyrat vetanake të bartura te shërbimet publike edhe ketu shpenzimi është i vogël po ashtu nuk është më mirë gjendja as te drejtorati për bujqësi, kulturë rini dhe sport etj.

Te arsimi parafillor kemi vonesë të projekteve po ashtu edhe te arsimi fillor kemi ngecje. Në përgjithësi ky vit duhet të merret me shqetësim krahasuar edhe me vitin e kaluar që kemi pasur zgjedhje.

Ukë Kryeziu, tha se kemi një raport të shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2018, po ndalemi në disa kategori me rëndësi është që të dijnë të gjithë qytetarët.

Te medijtjet dhe udhëtimet zyrtare jasht vendit në krahasim me vitin 2017 në vitin 2018 është rritur për 2 mijë euro nuk e dijnë se a ka pasur ndonjë ndryshim.

Bartja e nxënësve mbi 10 mijë euro, karburante shpenzimi mbi 10 mijë euro është një ndryshim i madh në krahasim me vitin e kaluar.

Mirëmbajtje të veturave mbi 10 mijë euro, ne e dijmë që operatori është nga komuna e Vitisë nga Pozhorani por nuk do të thotë që ajo duhet të fakturohet për shkak të largësisë që gjendet operatori.

Informimi publik mbi 12 mijë euro për postën për faturat e tatimit në pronë kjo është dashtë të jetë në tremujorin e parë e jo në tremujorin e dytë kur fillojnë ndëshkimet.

Furnizimi i zyreve mbi 8 mijë euro për mirëmbajtje e tavolinave dhe gjësendeve.

Te furnizimi në shëndetësi 5 mijë euro janë pak në krahasim me vitin e kaluar që kishim 24 mijë euro. Duhet të bëhet më teper për stamatologji të ket rritje të buxhetit po ashtu edhe te laboratorët nuk është gjendja e mirë ndërsa te barnatorja është gjendja diqka më e mirë. Shpenzime kontraktuale është vlerë shumë e madhe dhe nuk e dijmë se ku janë shpenzuar këto mjete. Te mirëmbajtja e investimeve është jo e mirë pasi që ne qdo ditë po investojmë por nuk po i mirëmbajmë.

Latif Ramadani, shumica e tyre janë borxhe nga viti i kaluar të cilat do t`i paguajm në këtë vit si që janë: postë, naftë etj. dhe ne e kemi shpenzuar buxhetin aq sa kemi mundësi. Sa i përket veturav në shkolla janë veturat për bartjen e nxënësve.

Selatin Retkoceri, qëllimi jonë nuk është me hudhë posht raportin, ekonomistat e kanë mësu parimin aktual ku shpenzimi ndodh momentin e faturimit jo në momentin e pagesës. Ne po kërkojmë që buxheti me u shpenzu jo me u bartë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, zakonisht në tremujorin e parë nuk bëhet alokimi i buxhetit në muajin janar. Te hyrat vetanake nuk kryhen në muajin janar dhe këtu ka procedura qysh duhet të bëhen shpenzimet, në muajin dhjetor nuk bëhen pagesat por zakonisht bëhen në muajin janar. Edhe në qoftë se pyetni pse ka rritje të shpenzimeve, karburanteve, bartjet e nxënësve atëherë duhet shiquar se a është bërë rritja e transportit për nxënësit.

Selatin Retkoceri, pyeti se ku e keni kontabilitetin

Imri Ahmeti, Kryetar, kemi problem me operatorë se nuk i bijnë fakturat me kohë as Standard benzi as koha ditore dhe zëri dhe nuk mundemi me e rexhistru si borxhe.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi dhe pauzë prej orës 12,³⁰

III

Propozim vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e tregut të kafshëve dhe vendosjen e tregut për produktet ushqimore për kafshë lëndë djegëse në ZK. Grackë e Vjetër

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Sefer Tasholli, drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, ne si grup e kemi shqyrtu këtë propozim vendim pasi që egëziston baza ligjore, po bëhet dy veprime një caktimi i lokacionit e dyta po bëhet ndarja e tregut të zhavorit dhe e tregut të gjallesave dhe tregu i zhavorit të drurit dhe në anën tjetër po bëhet zhvendosja e tregut të mëhershëm i cili nuk i ka plotësu kushtet.

Selatin Retkoceri, ky vendim është i mirëseardhur edhe për banorët kjo parcell po duket e mirë, është pak larg por ka rrugë dhe njerzit mund të shkojnë me vetura. Po për parcellen e dytë për zhavor dashta me ditë a është javor apo ditor. Prandaj ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar e përkrahim zhvendosjen e tregut pasi që tregu i vjetër gjendet në rrugë në udhëkryq dhe nuk i jep një pamje të mirë qytetit të Lipjanit.

Bashkim Budakova, edhe ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

Ramiz Qeriqi, pyeti se a do t'i ipet të njejtës kompani që e ka mirëmbajtur dhe a to të ia plotësojm kushtet na apo kompania.

Nazmi Krasniqi, edhe unë japë për, sepse në tregun e mëhershëm u bëjke tollovi por është mirë drejtori me na njoftu lidhur me këtë parceiië.

Albulena Kelmendi, ne e kemi shqyrtu edhe në KPF, drejtori ka qenë shumë preciz prandaj ne si grup e përkrahim dislokimin e këtij tregu në një vend të ri shpresoj që ky treg t'i plotësoj disa kushte dhe kriteret e bashkësisë evropiane, e jo të ketë tollovi si në tregun e mëhershëm.

Sefer Tasholli, tha se jemi në vitin ku po bëhet plani zonal dhe për ata po ngutemi të marrim vendimin dhe pastaj t'i caktojmë disa kriteret dhe kushte ashtu siq tha deputetja Albulena Kelmendi. Pastaj tha se është një kontraktor për tregun e mëhershëm të cilit do t'i skadoj kontrata për tregun e ardhshëm do të ketë procedura tenderimi dhe në ankand publik ai që do të ofroj kushte më të mira.

Meqë diskutime të tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR VENDOSJEN E TREGUT TË KAFSHËVE DHE VENDOSJEN E TREGUT PËR PRODUKTET USHQIMORE PËR KAFSHË DHE LËNDË DJEGËSE NË ZK GRACKË E VJETËR

Neni 1

1.Me këtë vendim caktohen lokacionet për vendosjen e tregut të kafshëve dhe produkteve ushqimore për kafshë dhe lëndë djegëse në ZK Grackë e Vjetër , si vijon:

1.1 Parcela kadastrale nr. P-71409080-00165-0 me sipërfaqe totale prej 15930m² (një hektar e pesëdhjetë e nëntë ari e tridhjetë metra), me kulturë arë e klasës 4 zona kadastrale Grackë e Vjetër, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan, për vendosjen e tregut të kafshëve.

1.2 Parcela kadastrale nr. P-71409080-00256-0 me sipërfaqe totale prej 6570m² (gjashtëdhjetë e pesë ari e shtatëdhjetë metra), me kulturë kullosë e klasës 3 zona kadastrale Grackë e Vjetër pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan, për tregtimin-shitblerjen e drithërave dhe produkteve të tjera ushqimore për kafshët dhe lëndëve djegëse (thëngjill, dru) etj.

Neni 2

Parcelat kadastrale nga neni 1 i këtij Vendimi destinohen në kuadër të Zonës Urbane Perëndimore “ZUP-4”, e cila definohet si Zonë Ekonomike M25 sipas Planit Zhvillimor Komunal i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.12514 të datës 23.08.2013.

Neni 3

Destinimi i parcelave kadastrale për vendosjen e tregut të kafshëve dhe për tregtimin-shitblerjen e drithërave dhe produkteve të tjera ushqimore për kafshët duhet të inkorporohet në Planin

Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale si dokumente të planifikimit të cilat janë në proces të hartimit sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.011-41550 të datës 01.08.2017.

Neni 4

Parcelat kadastrale do të shfrytëzohen vetëm sipas mënyrës siç përcaktohet në par.1.1 dhe 1.2 të nenit 1 të këtij Vendimi dhe në to nuk mund të vendoset zhavorr, gurë dhe gjëra të tjera që nuk i përgjigjen llojit të veprimtarisë për të cilën caktohen këto parcela.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronësor-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Inspektion dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, kompanisë regjionale Pastrimi-Prishtinë, njësia operative në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Sefer Tashollit, drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nazmi Krasniqi, tha se ne si institucion nuk po bëjmë sa duhet është mirë që të bëhet një ofertë dhe t'i japim shans edhe ndonjë kompanie tjetër për bartjen e mbeturinave pasi që

ne po i japim për grumbullimin e meturinave një ditore sepse ato mund të qëndrojnë deri një javë.

Linda Shahini, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim për ndarjen e lokacionit po ashtu e përkrahim vendimin për vendosjen e mbeturinave ditore.

Selatin Retkoceri, duke marrë parasysh që kompania regjionale e pastrimit është e Prishtinës është mirë që komuna me ju dhënë një vend të përhershëm me ju krijuar kushte pasi që e dijmë që kemi vështësi në punë dhe nuk mund të bartën mbeturinat brenda ditës, pasi që është fjala për të njejtin lokacion atëherë ne jemi për këtë propozim vendim

Afrim Miftari, tha se gjendjen financiare na e dijmë edhe në këtë mekanizëm të kufizuar por me këtë vendim po e largojmë kundërmimin po e bëjmë një zgjidhje më të mirë në krahasim me gjendjen e mëhershme.

Ukë Kryeziu, ne si grup e kemi shqyrtu dhe jemi pro vazhdimit të kontratës për sipërfaqen 2500m² por ne nuk po kuptojmë se me cilin Ligj është i paraparë grumbullimi i mbeturinave.

Sefer Tasholli, parcela në fjalë që kemi dhënë në shfrytëzim është deponi qe 30 vite. Ne këtë parcellë po e japim për shfrytëzim një ditore për akumulimin e mbeturinave. E pastaj prej aty do të bartim në destinacionin e duhur.

Ramiz Qeriqi, tha se unë jam për por me një vërejtje, nëse i hudhin mbeturinat jashtë kontinjerit t'i shkëputet kontrata.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS KOMPANISË REGJIONALE PASTRIMI-PRISHTINË, NJËSIA OPERATIVE NË LIPJAN

Neni 1

1 Me këtë Vendim, ndërmarrjes-kompanisë publike Regjionale "Pastrimi"-Prishtinë, njësia operative në Lipjan i ipen në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej 10 vitesh paluajtshmëritë-parcelat kadastrale si në vijim:

- 1.1. Parcela kadastrale nr. P-71409044-00842-2 me sipërfaqe prej 2500m² (njëzetë e pesë ari), në vendin e quajtur "Gubavica" zona kadastrale në Lipjan, me kulturë kullosë e klasës 2, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan.
- 1.2. Pjesa e parcelës kadastrale me sipërfaqe prej 4595m² (dyzet e pesë ari e nëntëdhjetë e pesë metra), nga parcela kadastrale nr. P-71409044-01131-0 me sipërfaqe totale prej 9191m² (nëntëdhjetë e një ari e nëntëdhjetë e një metër), në vendin e quajtur "Pashinke" zona kadastrale në Lipjan, me kulturë kullosë e klasës 2, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Parcela kadastrale siq përcaktohet në par.1.1 të nenit 1 të këtij Vendimi ipet në shfrytëzim me qëllim të vazhdimit të ushtrimit të funksioneve administrative nga ndërmarrja-kompania publike Regjionale "Pastrimi"-Prishtinë, njësia operative në Lipjan, shërbimet e së cilës janë shumë të rëndësishme për qytetarët e komunës së Lipjanit, dhe në të nuk lejohet vendosja qoftë edhe e përkohshme e kontejnerëve dhe e mbeturinave.

Ndërsa pjesa e parcelës kadastrale siq përcaktohet në par.1.2 të nenit 1 të këtij Vendimi ipet në shfrytëzim për grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave e cila do të shërbejë si pikë

transferimi, deri në transportimin-bartjen e tyre në lokacionin e destinuar për vendosjen e tyre në fshatin Mirash të Komunës së Obiliqit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Inspektion dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit “Sami Kelmendi” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit , drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nazmi Krasniqi, tha se nuk e di se a keni shqyrtu Ligjin ku për raste të veqanta nuk ka të drejtë Kryetari të shkruaj kontratë me organizata në bazë të Rregullores 23/ 2003, neni 20 nuk ka bazë ligjore por Kryetari duhet të nënshkruaj kontrata vetëm me nivelin qëndror.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne edhe në KPF e kemi shqyrtu këtë pikë këtu kemi edhe një kërkesë nga KF Lipjani që të zhvillohen ndeshjet në këtë stadium pa pagesë.

Ramiz Qeriqi, unë do të sqaroj në këtë pikë dhe do të jem a politik Ulpiana që është sot u formu në vitin 1992 është ndarë nga Slloga dhe kjo Ulpiana 1926 është formuar frik tash është formuar edhe KF Lipjani, kryetari i këtij klubi është Jeton Gashi i cili i pari ka hyrë në fushë dhe ka hekur fanelën e Sllogës dhe nuk ka dashtë me luajt në këtë klub. Kjo fushë e mbanë emrin e Sami Kelmendit e të cilit në atë kohë i kanë kërkuar që të largohet nga fusha pasi që i kanë thënë se je familje nacionaliste. Tash duhet ta dijmë se a jemi për Sllogën për Ulpianën apo KF Lipjanin.

Të gjitha klubet edhe Ulpiana edhe Arbëria po ashtu edhe KF Lipjani kanë statusin e barabart të OJQ-ve andaj kërkojmë që t'u lejohet që t'i kryejn stervitjet. Edhe Arbërisë në këtë stadium me të drejtat e barabarta të gjitha i kanë. Kam bërë pyetje në stadiumin e Prishtinës luan e Flamurtari me të drejtat e barabarta, andaj kërkoj që edhe këtu të u lejohet njejtë të startojnë në stervitje në mënyrë që mos të ketë ndonjë mosmarrëveshje.

Selatin Retkoceri, tha se duhet me ju dhënë stadiumin por duhet të kenë kujdesë si do të trajtohen klubet tjera pasi që ato mund të kushtëzohen me pagesë, është mirë që kjo qështje të definohet mirë që në të ardhmen mos të ketë probleme.

Aafirim Miftari, ne edhe në KPF e kemi diskutu këtë qështje, është mirë që të definohet se kush menagjon me klubin pasi që edhe këto do të kenë obligime të rrymës etj. dhe ne jemi që të ipet kontrata, qështja tjetër si do të merren vesh ata ju takon atyre.

Albulena Kelmendi, ne edhe në KPF e kemi diskutu këtë qështje, por edhe sqarimet sot që na i dha drejtori në Kuvend, kur e dijmë që Lipjani operon me dy klube KF Ulpiana 1926 dhe KF. Lipjani dhe këtu shumë mirë po thuhet se stadiumi nuk ka me qenë i një ekipit por do të ipet në shfrytëzim, dhe është mirë që të bëhet një zgjidhje për të dyja ekipet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Kuvendit, tha se klubi është trashëgimi i një klubi të mëparshëm, ndërsa klubet tjera janë të mirë se ardhura. Sa i përket stadiumit ai është aset i Komunës dhe nuk mund t'i lejojmë kush do qka do të bëjë janë ligjet ato që e rregullojnë këtë qështje.

Ramiz Qeriqi, tha se në Gjilan janë dy ekipe të dyjat luajnë në të njëjtin stadium, kërkesa ime është që ekipi tjetër i qytetit këtu në Lipjan ta shfrytëzoj pa pagesë stadiumin pasi që është ekipë e qytetit. Klubi Ulpiana është shu për shkak të borxheve dhe klubi i ri është formu frik nuk është ai i vjetri.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se nuk jemi kundër dhënjes në shfrytëzim të stadiumit por është mirë që të precizohet që ky ekip me ju dhënë hapsirë klubeve tjera që kanë me u formu në të ardhmen.

Albulena Kelmendi, ne nuk jemi për mos dhënjen në shfrytëzim stadiumin pasi që janë dy klube dhe kërkesa ime është që me ua leju aktivitetet të dy ekipeve dhe qysh i bëjnë kushtet e bashkë rendimit ata e dijnë edhe një herë theksoj se nuk jemi për mos me ua dhënë në shfrytëzim.

Imri Ahmeti, tha se klubi i ri nuk është i rëngut të njëjtë KF Ulpiana pasi që Ulpiana ka histori më të gjatë të cilën e dini edhe ju, ndërsa klubi tjetër është ende i ri dhe ne nuk mundemi që stadiumin ta lëmë në dorë të gjithkujtë pasi që ai është aset i Komunës dhe duhet për këtë të ketë përgjegjësi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, neni 2 thotë që edhe klubet tjera kanë të drejtë me e shfrytëzu këtë stadium dhe ne jemi që kjo të bëhet.

Imri Ahmeti, nuk e dijë se a jini në dijeni se sa klube deshirojnë me ardh me luajt në këtë stadium dhe nuk munden të gjitha pasi që nuk i nxen.

Naim Stullca, KF Dobraja ka paguar çdo lojë nga 15 euro të cilën e ka luajtur në Lipjan.

Daut Azemi, Kryesues, edhe unë dua ta bëjë një sqarim Gjilani i ka 2 klube edhe Prishtina i ka 6 klube por secili klub e ka stadiumin e vet. Dhe klubi që formohet ndeshjet mund t'i luajnë në stadiumin tjetër por për stervitje duhet ta bëjë zgjidhjen vetë.

Nazmi Krasniqi, disa gjëra i tha shumë mirë Kryetari por në udhëzim administrativ caktohet shumë mirë se kush mund ta shfrytëzoj stadiumin dhe është mirë që ka njerëz që investojnë në sport.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 votat për, 7 kundër 5 apstenime, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË STADIUMIT TË FUTBOLLIT “ SAMI KELMENDI” NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim i ipet në shfrytëzim Klubit të futbollit “Ulpiana 1926” prona e paluajtshme shoqërore STADIUMI I FUTBOLLIT “Sami Kelmendi” në Lipjan në vendin e quajtur Gllavnik, për periudë 15 (pesëmbëdhjetë) vite, për rastet e veçanta, në sipërfaqe të terësishme prej 1.06.30 ha, tipi i pronës- pronë shoqërore evidentuar në emër të d/s sportsko drushtvo sloga, Zona Kadastrale Lipjan, me shfrytëzim aktual, Shërbimet Publike –Fushë Sportive, e evidentuar në fletën poseduese nr. 3436/18 në parcelat kadastrale P-71409044-01370-1, P-71409044-01370-2, P-71409044-013710-0, sipas Kërkesës së Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport- Departamenti i Sportit Nr.861/2018 të datës 04.07.2018 dhe kërkesës së Klubit të Futbollit” Ulpiana 1926” 1-030-40972 të datës 04.07.2018.

Neni 2

1. Prona e cekur në nenin 1, ipet në shfrytëzim konform dispozitave të cekura të Ligjit Nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK NR.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim

dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës **për rastet e veçanta**, pa procedurë të konkurimit konform kërkesës së parashtruar nga organet qendrore të Republikës së Kosovës – përkatësisht Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

2. Prona e cekur aktualisht dhe në të kaluarën ka qenë në shfrytëzim për qëllime sportive ku edhe paraprakisht me Vendim të Kuvendit Komunal 1Nr.465-221 të datës 04.8.2003 i është bartur e drejta e shfrytëzimit të patundshmërisë shoqërore nga Shoqata Sportive “Slloga” në Klubin Futbollistik “Ulpiana” në Lipjan për periudhë 10 vjeqare.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi obligohet Sektori pronëso-ro-juridik që në bashkëpunim me Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport të përgadisnin formën e Kontratës në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe KF “Ulpiana 1926” për mënyrën e shfrytëzimit dhe menaxhimit të Stadiumit e cila do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i Klubit KF “Ulpiana” 1926.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Bekim Shabanit , drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, po shpresoj që sa më shpejt me u bë kjo Rregullore por kem edhe një kërkesë që në këtë Rregullore të ceket që kategoritë e dalura nga lufta dhe rastet sociale të mos paguajnë antarësi, po ashtu kërkoj që ditën e varrimit hoxhollarët mos të ju kërkojnë pare. Po ashtu edhe një kërkesë tjetër që veteranëve të luftës, invalidët të kenë një ceremoni prej Komunës.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 votat për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës, për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **7700 €**, (shtatëmijë e shtatëqind euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 70 raste të vdekjes, me nga 110 Euro për secilin rast $70 \times 110 = 7700$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web fagen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Informatë rreth testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës-afati Qershorit 2018

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, kur diskutojmë për arsimin duhet të jemi prezentë të gjithë në mbledhje jo të mungojmë. Rezultati është i keq, ashtu si e kemi keq arsimin tregohet edhe suksesi. Është mirë të jetë sa më real, e nëse është real duhet të jemi të kënaqur në veqanti me gjimnazin. Po ashtu në Lipjan rezultati është mirë, ndërsa në shkollën "Fehmi Agani" në Medvec është më së keqi. Nënë mesatarën e testit i kemi 16 shkolla.

Shkolla e mesme drejtimi profesional është gjendja shumë e keqe ku përqindja është vetëm 22%, ndërsa gjimnazi është mirë 79% nëse është rezultat real. Unë e pres që së shpejti me dalë ju me një raport për arsim pasi që pa arsim nuk ka as zhvillim ekonomik as shëndetësi.

Egzona Fazlija, bazuar në rezultatet e testit të arritshmërisë dhe testit të maturës Komuna e Lipjanit nuk ka treguar një rezultat të knaqshëm. Në përgjithësi në arsimin e komunës së Lipjanit mungon analiza e mirëfilltë. Kam një pyetje për ju Kryetar dhe drejtorin e DKA-se se a jeni të kënaqur me rezultatin e arritshmërisë dhe testin e maturës kur e dijmë se pa një arsim cillësor nuk mund të arritet asgjë.

Majlinda Sylejmani, e falenderoj drejtoratin e arsimit, më vjen mirë që ka shkuar gjithëçka në rregull. Nuk është shumë i knaqshëm rezultati i arritur por nëse e krahasojmë me vite tjera është shumë më i mirë, por kërkoj nga DKA-ja që të zbatohen kritere më të forta për regjistrimin e nxënësve.

Nehat Tërpeza, falenderoj drejtorin e arsimit për këtë informatë, se sa është gjendja reale e këtij testi mbetet për të dëshiruar. Fajtor kryesor për mua si mësimdhënës si prind është ministria e arsimit ku ky testë shkakton stres te nxënësit dhe është i deshtuar, ku ndodh që nxënësi të ketë sukses të shkelqyer dhe të deshtoj në test ose nxënësi i dobët ta kaloj testin. Ministria e arsimit po bënë eksperimente me nxënës njëherë testin e klasës së 5-te tani klasës së 9-të tani 13-ta e më vonë hiqet krejt klasa e 13-te dhe me këtë shihet që ministria e arsimit ka dështuar.

Linda Shahini, fusha e arsimit është ndër fushat më të ndjeshme, komuna e ka për obligim që të investoj nëpër shkolla, ndërsa ministria duhet të ketë një platformë sa më të mirë për arsim.

Albulena Kelmendi, rezultatet e testit kombëtarë nuk është përgjegjësi e DKA-s kjo është kompetence e ministrise, arsimtarët nuk janë nga Lipjani kur e dime që testi ka rrjedhë para një kohe në rrjetet sociale, testi nuk ka qenë real por nuk kemi mujt të bejmë ma shumë lidhur me këtë qështje.

Nazmi Krasniqi, e kam percjelle këtë informate rezultati është brengos,ës për disa shkolla por fajet i ka niveli qendror. Do të ishte mirë që si model të mirret Shqipria, po ashtu edhe inspektoriati se kryen punën si duhet. Arsimi është problem në tërë Kosovën jo vetëm Lipjan

Afrim Miftari, tha nëse diqka e keqe i ka ndodh këtij vendi, janë kopi paste planet nga nivelet kombtare. Te gjimnazi rezultati është i kënaqshëm, ndërsa në shkollat profesionale rezultatet janë jo të mira.

Ukë Kryeziu, të gjithë po pajtohem se gjendja në arsim nuk është e mirë, por kërkush nuk po e merr përgjegjësinë për këtë qështje, unë e kam një pyetje sa jemi të gatshëm ne më bo ma shumë për arsim? Ky test është sa për mu mbulu minsitria se po punojna diqka, gjendja duhet të ndryshohet nëse edhe Kryetari edhe drejtori i arsimit, drejtorët e shkollave edhe arsimtarët angazhohen ma shumë. Se sa është gjendja cilësore në arsim e ka tregu rezultati i PISA-s. Unë për fund i bëj thirrje të gjithë atyre që kanë ndikim ne procesin e arsimit të bëjnë ma shumë për arsimin.

Hyra Bytyqi, te gjithë po pajtohem qe gjendja në arsim është e keqe .Ministria e arsimit nuk ka apliku nji strategji te mirfillt ne arsimë për këtë mungon edhe cilësia në arsim. Ajo që na takon neve si komunë ti shohim mangësit dhe arritjet e nxënëve dhe të fokusohemi në aftësit konkurse.

Rasim Hasani, në shkollat ku është pritë rezultati ka dal i mirë siq janë gjimnazi, shkolla profesionale drejtimet ekonomi dhe juridik. Ne i kemi dhënë rezultatet të cilat janë reale.

Imri Ahmeti, raporti i PISA-s tregon më së shumti qyshe e kem gjendjen në arsim, por ky nuk asht rezultat i asnjë individi, as i një personeli arsimor ,as një ministrie as i një kryetari as i një Komune por është rezultat i punës së mëhershme sepse sa herë u qelke nga nji universitet ne i duartrokitshim. E kjo ashtë ajo që ne nuk po mund të dalim nga kjo gjendja e rënd në arsim

Me që diskutime të tjera rreth kësaj pikë nuk pati u kalua në pikën tjetër të rendit të ditës

VIII

Prezentimi i Raportit të Auditorit të Pavarur të Kosovës për pasqyrat financiare për vitin 2017 të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën , Latif Ramadanit drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu. ne si grup opozitar e kemi thirr një mbledheje te jashtzakonshme ku në atë mbledhje kemi kërkua të debatojmë për raportin e auditorit mirëpo, në atë mbledhje kanë munguar partitë e pozitës së bashku me drejtorët .Sot nuk do të marrim pjesë në këtë mbledhje pasi që për këtë qështje ju kemi drejtu organeve te drejtsisë me kallzim penal.

Selatin Retkoceri, auditori i ka përfshi pasqyrat financiare ,ne numër ka shumë të gjetura gjë që është praktikë e kontrollorve të auditimit. Raportin duhet vlerësuar si real me disa të gjetura teknike. Normale është me ndodh ndonjë gabim por kur të bëhet zotimi i mjeteve duhet të kemi kujdesë . Nga rekomandimet del se 9 prej tyre kanë filluar të zbatohen ndërsa 7 prej tyre ende jo. Unë mendoj se është një raport i mirë dhe i vlersuar.

Imri Ahmeti, unë e kam prit që kjo pikë ka me u diskutu në kuvend por opozita nuk ken te gatshëm. Opinioni e din se Lipjani nuk ka pasur kurrë auditim më të mirë. Niveli më i lart është se e kemi plotësuar njërin prej kriterëve, kriterin për kredi të buta. Për fund e shfrytzoj rastin me i falenderu drejtorët ,punorët e administratës për punën qe po e bëjnë .

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit, i njoftoj anëtarët e kuvendit se muaji gusht do të jetë muaj pushimi dhe seanca e radhes do të jetë në shtator.

Pasi që qështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,²⁶

Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi